

## ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04 L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Për: **K. Regj. e Mbeturinave Pastërtia SH.A.**

Për Aktivitetin e Prokurimit

**Titulli: Shërbimet e Dezinfektimit, Dezisektimit dhe Deratizimit për nevojat e KRM Pastërtia SH.A. për objektet administrative dhe operative të saj në të gjitha Njësitë e saj**

Nr1 i prokurimit	KRMFe-26-1048-2-2-1
Nr i brendshëm	

### 1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK

**Besim A.Zejnullahu B.I**

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rr. Reqakut, p.n

(Adresa)

Ferizaj

(Vendi)

044138490

(Numri Telefonit)

70000

(Kodi postar)

\_\_\_\_\_  
(Numri i Faks-it)

**Besim Zejnullahu**


(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

ekoddd@hotmail.com

(Adresa elektronike)

30.05.2026

(Data e parashtrimit të kërkesës)



\*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

<sup>1</sup> Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

## 2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

\_\_\_\_\_  
(Emri i avokatit)

\_\_\_\_\_  
(Adresa e plotë)

\_\_\_\_\_  
(Numri i Telefonit)

\_\_\_\_\_  
(Numri i faks-it)

\_\_\_\_\_  
(Adresa elektronike)

\_\_\_\_\_  
(Data e parashtrimit të ankesës)

\_\_\_\_\_  
(Nënshkrimi dhe vula)

## 3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftimi për kontratë: 05.03.2026

Hapja e ofertave: 06.05.2026

Vendimi i AK-se: 18.05.2026

Letra standarde si tenderues i pasuksesshem:18.05.2026

Kërkesa për qasje: 18.05.2026

Lejimi i qasjes : 19.05.2026

Kërkesa për ri-shqyrtim me dt.20.05.2026

Vendimi mbi refuzimin e kërkesës për ri-shqyrtim me dt.21.05.2026

#### 4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

Jo

#### 5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

Jo

#### 6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po

Jo

Kundër vendimit për dhënje të kontratës kemi parshtruar kërkesë për ri-shqyrtim tek **AK- K. Regj. e Mbeturinave Pastërtia SH.A.** me dt. 20.05.2026.

**AK- K. Regj. e Mbeturinave Pastërtia SH.A.** me dt. 21.05.2026 na njofton me vendimin mbi refuzimin e kërkesës për ri-shqyrtim lidhur me aktivitetin e prokurimit : Shërbimet e Dezinfektimit, Dezinfektimit dhe Deratizimit për nevojat e KRM Pastërtia SH.A. për objektet administrative dhe operative të saj në të gjitha Njësitë e saj, nr i prokurimit **KRMFe-26-1048-2-2-1** ” me arsyetimin se kërkesa për ri-shqyrtim është e pa bazuar.

Bazuar në dispozitat e nenit 109 të LPP parashtrorj ankesë kundër vendimit për refuzim të kërkesës për ri-shqyrtim si dhe kundër njoftimit për dhënje të kontratës dhe letrës standarde si OE i pasuksesshem .

#### 7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

- **Dispozitat e shkelura:**
- **Neni 1**
- **Neni 6**
- **Neni 7**
- **Neni 56**
- **Neni 59**
- **Neni 72 dhe udhezuesi Nr.002/2024**

Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund

të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.

## 8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

*Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.*

Në pajtim me dispozitat e nenit 109 të LPP-ës parashtrojmë këtë ankesë kundër vendimit të **AK K. Regj. e Mbeturinave Pastërtia SH.A.** mbi refuzimin e kërkesës tonë për rishqyrtim si dhe njoftimit për dhënie të kontratës OE BEST DDD SHPK si dhe letrës standarde si OE i pasuksesshem lidhur me aktivitetin e prokurimit: Shërbimet e Dezinfektimit, Dezinfektimit dhe Deratizimit për nevojat e KRM Pastërtia SH.A. për objektet administrative dhe operative të saj në të gjitha Njësitë e saj me nr.të prokurimit KRMFe-26-1048-2-2-1,

AK me rastin e rishqyrtimit të kërkesës sonë nuk ka vepruar konform nenit 108A të LPP me qëllim të evitimit të gabimeve me rastin e vlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit të ofertave, por e njëjta ka refuzuar kërkesën si të PA BAZUAR.

Më tutje e sqarojme si është dërguar kërkesa pranë AK-së

Pas pranimit të letrës standarde dhe Njoftimin për Vendim-Shpërblim me kontratë kemi kërkuar nga AK qasje në dokumentacionin e OE të rekomanduar për kontratë.

AK me datën 19.05.2026 na ka dërguar dokumentacionin e OE të rekomanduar për kontratë ne e-prokurim dhe pas kontrollit të dokumenteve vërtetuam se i njëjti nuk i plotëson kriteret e kërkuara dhe kemi ardhur në përfundim se OE i rekomanduar është i papërgjegjshëm duke mos i plotësuar kriteret e NJK-së dhe DT-së, andaj do të gjeni pretendimet ankimore të paraqitura si më poshtë për secilën shkelje.

### **Pretendimi nr.1**

Ne si OE kemi ofertuar në këtë aktivitet të prokurimi me çmim prej **5,400 €** ndërsa OE të cilin AK ka shpërblyer me kontratë ka ofertuar me çmim prej **8,850 €**, ku shihet se është një diferencë prej 3,450 Euro që është me i lartë për 63.8% se sa oferta e jonë. Duke mos pas parasysh kursimin e buxhetit publik siç e parasheh neni 1 dhe 6 të LPP-së, AK edhe pse me dëmtim buxheti për një shumë të majme sic e cekëm më lartë ka dëmtuar buxhetin publik dhe kjo është shkelje e rëndë dhe njëkohësisht edhe diskriminim duke e shpërblyer me kontratë një OE të papërgjegjshëm dhe duke na diskriminuar padrejtësisht.

Me këtë AK Nenet e cekura më lartë i shkel pa turp fare duke mos u munduar që fondet publike të përdoren në mënyrë më ekonomike. Do të ishte krejt në rregull dhe konform LPP-së sikur vlerësimi i ofertave për të gjithë Operatorët të bëhet njëjtë duke mos i anashkaluar kriteret e përcaktuara në DT. Arsyet e eliminimit janë të pabazuara dhe ne do të ua dëshmojmë të kundërtën që do të shihni profesionalizmin e AK-se që e bëni të pamundurën për të diskriminuar dhe favorizuar OE për të cilin dyshohet se edhe ka përgaditë kriteret fillimisht në njoftimin për kontratë.

Per kete pretendim AK eshte pergjigjur

### **Përgjigje ndaj pretendimit nr.1**

Ju, si OE së pari duhet të jeni të përgjegjshëm (të kompletuar me dokumentacionin e kërkuar dhe të dorëzoni ofertën ashtu siq duhet) në mënyrë që ne si AK-komisioni vlerësues ta marrë ofertën Tuaj si të përgjegjshme.

Ju sqarojmë se komisioni vlerësues ka shqyrtuar dhe analizuar ofertën tuaj ashtu siq Ju e keni plotësuar, dmth oferta juaj ka vlerën 900.00 €, ndërsa sa i përket vlerës prej 5400.00 € nuk e dijmë se çfarë keni patur në mendje Ju kur keni shënuar tek totali atë shifër, dhe me të drejtë komisioni vlerësues bazuar në LPP (po në ligjin që thirreni ju në këtë ankesë) neni 40 pika 9 e Rregullores nr. 001/2022 për Prokurim Publik ju ka eliminuar.

Arsyetimi i AK-së se nuk ka qenë në dijeni se çfarë kemi pasur ne për qëllim gjatë plotësimit të formularit dhe llogaritjes së vlerës prej 5,400.00 euro është i pabazuar dhe i papranueshëm. Një arsyetim i tillë tregon se AK nuk ka bërë një analizë objektive të përmbajtjes së ofertës sonë dhe të formularëve të dorëzuar, pavarësisht se mënyra e llogaritjes dhe vlera totale e ofertës janë paraqitur qartë dhe në përputhje me kërkesat e formularit të përgatitur nga vetë AK.

Për më tepër, kundërshtojmë në tërësi pretendimin e AK-së se oferta jonë përmban gabim aritmetik. Oferta jonë përfshin qartë çmimin për njësi, si dhe çmimin total të ofertës, të llogaritur sipas kërkesave dhe strukturës së përcaktuar në Formularin e Çmimit nga Autoriteti Kontraktues. Vlera totale prej 5,400.00 euro është rezultat i aplikimit të kërkesave të përcaktuara në formular dhe përputhet plotësisht me shumën e paraqitur në Formularin e Tenderit.

Rrjedhimisht, në ofertën tonë nuk ekziston asnjë gabim aritmetik dhe asnjë mospërputhje ndërmjet Formularit të Çmimit dhe Formularit të Tenderit. Përkundrazi, interpretimi i AK-së është i pasaktë dhe nuk mbështetet në faktet dhe dokumentacionin e dorëzuar në procedurën e prokurimit.

### **Pretendimi nr.2**

Arsyetimi i pranuar nga AK i cekur në letrën standare të pranuar me datë 18.05.2026 është si në vijim:

“ Oferta e juaj ka mosperputhje te cmimit dhe ka gabim mbi 2% te vleres;

Tek formulari i dorezuar i tenderit dhe procesverbali i hapjes totali i cmimit/ofertes eshte vlera 5,400.00 €, ndersa ne oferte /paramase tek cmimi per njesi keni shenuar vleren  $3000 \times 0.3€ = 900 €$ , ndersa te totali i saj keni shenuar vleren 5,400.00 € me te cilen ka mosperputhje te cmimit dhe e tejkalon vleren prej 2% e gabimit aritmetikor te lejuar bazuar ne Rregulloren nr.002/2024 per plotesim dhe ndryshim te rregullores nr.001/2022 per prokurim Publik, neni 40.9, pika b.

Konsiderojmë se vendimi i AK-së është i pabazuar në faktet dhe dokumentet e tenderit, për arsyet në vijim:

### **1. NUK EKZISTON GABIM ARITMETIK NË OFERTË**

Në formularin e çmimit është specifikuar:

- Njësia: m<sup>2</sup>
- Sasia: 3000
- Çmimi për njësi: 0.30 €

- Vlera: 900.00 €

Llogaritja e mësipërme është matematikisht e saktë. Prandaj, nuk ekziston asnjë gabim aritmetik në përlllogaritjen e çmimit njësi dhe vlerës përkatëse.

**. VLERA 5,400.00 € ËSHTË LLOGARITUR SIPAS KËRKESËS SË VETË AK-së**

Në fund të tabelës së çmimeve, AK ka vendosur sqarimin:

*“Sqarim shtesë: Shërbimet e Dezinfektimit, Dezinfektimit dhe Deratizimit për nevojat e kompanisë KRM "Pastërtia" Sh.A. duhet të bëhen konformë kërkesave të kompanisë dhe specifikimeve teknike të dosjes së tenderit: së paku 2 herë brenda 1 viti, për një periudhë 3 vjeçare të kontratës, për metrat katror të përshkruara në paramasë.”*

po ashtu **ne table te Vlera Totale** eshte e shenuar nga vet AK , **Vlera Totale përfshirë të gjitha Shërbimet e DDD-së sipas kërkesave dhe specifikimeve teknike**

Duke u bazuar në këtë kërkesë të dosjes së tenderit, ne kemi llogaritur vlerën totale kontraktuale si vijon:

- 900.00 € për një cikël shërbimi;
- 2 herë në vit = 1,800.00 €;
- për 3 vite kontratë = 5,400.00 €.

Pra:

$$900.00 \text{ €} \times 2 \times 3 = 5,400.00 \text{ €}$$

Kjo tregon qartë se shuma 5,400.00 € nuk është rezultat i gabimit aritmetik, por rezultat i aplikimit të kërkesave dhe sqarimeve të vendosura nga vetë Autoriteti Kontraktues në formularin e tenderit.

**3. FORMULARI I AK-së KA LEJUAR INTERPRETIM TË ARSYESHËM**

Struktura e formularit dhe sqarimi i vendosur në fund të tabelës kanë krijuar bazë të arsyeshme që ne si operator ekonomik të paraqesim:

- çmimin për një intervenim/shërbim në kolonën përkatëse;
- dhe vlerën totale të kontratës për periudhën 3-vjeçare.

Prandaj, nuk kemi të bëjmë me “gabim aritmetik eliminues”, por me interpretim të formularit sipas udhëzimeve të AK-së

**4. AK KA PASUR MUNDËSI TË KËRKOJË SQARIME**

Edhe nëse AK ka konsideruar se ekziston paqartësi në ofertë, e njëjta nuk përbën ndryshim të substancës së ofertës dhe nuk ndikon në çmimin për njësi.

Në këto rrethana, AK ka pasur mundësi ligjore të kërkojë sqarime nga ne, në vend të eliminimit të menjëhershëm të ofertës.

Duke u bazuar në të gjitha faktet e lartcekura, kemi kërkuar nga Autoriteti Kontraktues që:

1. Të anulohet vendimin për refuzimin/eliminimin e ofertës sonë;
2. Të konstatojë se nuk ekziston gabim aritmetik mbi 2%;
3. Të bëjë rivlerësimin e ofertës sonë në përputhje me dosjen e tenderit dhe dispozitat ligjore të prokurimit publik.

Lidhur me këtë pretendim, në përgjigjen ndaj kërkesës për rishqyrtim AK ka dhënë disa sqarime, mirëpo ne vazhdojmë të qëndrojmë prapa faktit se oferta jonë është përgatitur dhe plotësuar në përputhje të plotë me kërkesat e përcaktuara në formularin e çmimit dhe dokumentacionin e tenderit.

Në ofertën tonë kemi paraqitur çmimin për njësi, i cili pas shumëzimit me sipërfaqen e kërkuar në m<sup>2</sup> ka rezultuar me çmimin për një intervenim. Ndërsa në rreshtin e fundit të tabelës, AK ka kërkuar që të paraqitet vlera totale e të gjitha shërbimeve DDD sipas specifikimeve teknike, me realizim dy herë brenda vitit për një periudhë trevjeçare. Pikërisht mbi këtë bazë është llogaritur dhe paraqitur vlera totale prej 5,400.00 euro, e cila është reflektuar edhe në Formularin e Tenderit.

Sipas nenit 40.10 pika (b) të Rregullores Nr. 001/2022, oferta mund të refuzohet në rast se ekziston mospërputhje ndërmjet çmimit total të deklaruar në Formularin e Tenderit dhe totalit të paraqitur në Formularin e Përshkrimit të Çmimit. Në rastin tonë, një mospërputhje e tillë nuk ekziston, pasi çmimi total në Formularin e Tenderit dhe çmimi total në Formularin e Përshkrimit të Çmimit janë identikë, përkatësisht 5,400.00 euro. Për rrjedhojë, nuk ekziston asnjë bazë ligjore për eliminimin e ofertës sonë mbi këtë arsye.

Një çështje me rëndësi të veçantë, të cilën AK nuk e ka trajtuar fare në vendimin e saj, lidhet me mundësinë reale të ekzekutimit të kontratës nga Operatori Ekonomik i shpallur fitues. Nga analiza e Formularit të Përshkrimit të Çmimit të operatorit të shpërblyer me kontratë rezulton se ai ka ofertuar çmimin prej 2.95 euro për m<sup>2</sup>.

Duke u bazuar në këtë çmim për njësi dhe në vlerën totale të ofertës së tij, rezulton se me realizimin e vetëm një intervenimi për sipërfaqen prej 3,000 m<sup>2</sup> do të konsumoheshin të gjitha mjetet e kontratës. Kjo do të thotë se kontrata do të mund të realizohej vetëm për një intervenim të vetëm, ndërsa nuk do të mund të përmbusheshin kërkesat e specifikimeve teknike, të cilat qartë kërkojnë realizimin e shërbimeve DDD dy herë në vit për një periudhë prej tre (3) vitesh.

Duke qenë se çmimi për njësi është element kontraktual dhe nuk mund të ndryshohet pas nënshkrimit të kontratës, operatori ekonomik i shpërblyer nuk do të jetë në gjendje të realizojë shërbimet sipas kërkesave të tenderit. Për pasojë, oferta e tij është në kundërshtim me kushtet e dosjes së tenderit dhe nuk garanton ekzekutimin e kontratës sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktues.

Po ashtu, çmimi prej 2.95 euro për m<sup>2</sup> është dukshëm më i lartë se çmimet e zakonshme të tregut për këto shërbime. Sipas praktikës së tregut vendor dhe rajonal, çmimet për shërbimet DDD zakonisht nuk tejkalojnë vlerën prej 1.00 euro për m<sup>2</sup>. Kjo diferencë e konsiderueshme ngre dyshime serioze lidhur me vlerësimin e ofertave dhe përputhshmërinë e tyre me kërkesat e tenderit.

Për këto arsye, kërkojmë nga OShP që të mos e anashkalojë këtë çështje thelbësore gjatë shqyrtimit të ankesës, por të analizojë në mënyrë të detajuar përputhshmërinë e ofertës së operatorit të shpërblyer me kontratë me kërkesat e dosjes së tenderit dhe mundësinë reale të ekzekutimit të kontratës sipas kushteve të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktues.

### **Pretendimi nr.3**

Në DT të Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare të nenit 8.1 & 8.2 të Kapacitetit ekonomik dhe financiar AK ka kërkuar Kërkesa 1. Operatori ekonomik ose grupi i Operatorëve Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi të kënaqshme Autoritetit kontraktues se qarkullimi vjetor (të hyrat) e OE-së për periudhën e shkuar trevjeçare ka qenë jo më pak se 40,000.00€, ndërsa si dëshmi keni kërkuar Dëshmia 1. Dokumentacion që vërteton gjendjen dhe aktivitetin financiar të OE-së, i shoqëruar me qarkullimin financiar nga banka për tri vitet e fundit (2024, 2025, 2026) ose deklaratat vjetore tatimore të dorëzuara në Administratën Tatimore të Kosovës

Operatori Ekonomik i rekomanduar nuk e ka dëshmuar përmbushjen e kriterit financiar të përcaktuar në Dosjen e Tenderit, sipas të cilit kërkohet që OE të ofrojë dëshmi të kënaqshme se qarkullimi vjetor (të hyrat) për periudhën trevjeçare ka qenë jo më pak se 40,000.00 €.

OE në fjalë nuk ka dorëzuar deklaratat të ATK-së apo ndonjë dokument tjetër zyrtar financiar që vërteton të hyrat e kërkuara. Fakti që dokumentet bankare janë deklaruar konfidenciale nuk përbën dëshmi të mjaftueshme për përmbushjen e kriterit financiar.

Edhe në rast se qarkullimi bankar i Operatorit Ekonomik do të ishte mbi 40,000.00 €, një dokument i tillë nuk përbën dëshmi të mjaftueshme për përmbushjen e kriterit të kërkuar në Dosjen e Tenderit.

Kërkesa e Autoritetit Kontraktues ka qenë e qartë dhe specifike, duke kërkuar dëshmi lidhur me “qarkullimin vjetor (të hyrat) e OE-së për periudhën e shkuar trevjeçare”. Qarkullimi bankar nuk barazohet me të hyrat vjetore të operatorit ekonomik, pasi llogaria bankare mund të përfshijë transfere, kredi, hua apo transaksione të tjera që nuk paraqesin të hyra reale nga aktiviteti ekonomik i OE-së.

“Edhe pse Dosja e Tenderit ka paraparë mundësinë e dorëzimit të qarkullimit bankar si dëshmi alternative, një dokument i tillë duhet realisht të dëshmojë përmbushjen e kriterit të kërkuar, përkatësisht të hyrat vjetore të Operatorit Ekonomik.

Vetë fakti i paraqitjes së qarkullimit bankar nuk nënkupton automatikisht përmbushjen e kriterit financiar, pasi qarkullimi bankar mund të përfshijë:

- transfere të brendshme,
- kredi,
- hua,
- depozita,
- pagesa të përkohshme,
- transaksione jo-operative,
- dhe lëvizje të tjera financiare që nuk paraqesin të hyra reale nga aktiviteti ekonomik i OE-së.

Për këtë arsye, qarkullimi bankar nuk mund të trajtohet automatikisht si dëshmi e barasvlershme me deklaratat tatimore apo pasqyrat financiare, përveç nëse nga ai dokument vërtetohet qartë dhe në mënyrë të matshme niveli i të hyrave reale vjetore të operatorit ekonomik.

Autoriteti Kontraktues ka obligim të bëjë vlerësim substancial të dëshmimeve dhe jo vetëm formal të ekzistimit të dokumentit, edhe pse në pergjigjen e tyre gjate kërkeses për rishqyrtim AK ka deklaruar se dokumneti I ofruar nga OE Best DDD ka pas qarkullim 50,000 Eur brenda tri viteve.

Meqense ne si OE nuk kemi pas qasje ne dokumentin e ofruar per qarkullim bankar kerkojme nga OSHP te verifikoje se dokumentin e ofruar per qarkullim banakar te analizohet mire dhe te merren si te hyra vetem pagesat e pranuar (pagesat nga blesit per faturat e leshuara nga OE) e jo transaksionet tjera qe jane realizuar ne llogarine bankare sepse siq e cekem me larte ne qarkullimin bankar mund te perfshihen edhe kredi, depozita, pagesa te tatimeve, pagesat e pagave te punetoreve apo pagesa tjera qe nuk paraqesin te hyrat e kompanise.

Në rastin konkret, nga dokumentacioni i OE të rekomanduar nuk provohet në mënyrë të qartë se qarkullimi bankar i dorëzuar përfaqëson të hyra reale operative për periudhën e kërkuar trevjeçare.

Prandaj, konsiderojmë se AK ka bërë vlerësim të gabuar të kriterit financiar dhe ka trajtuar si të përmbushur një kriter që nuk është dëshmuar në mënyrë të mjaftueshme dhe të qartë.”

Prandaj, vlerësimi i Autoritetit Kontraktues se OE i rekomanduar i plotëson kriteret financiare është bërë në kundërshtim me kërkesat e Dosjes së Tenderit dhe me parimet e trajtimit të barabartë, transparencës dhe vlerësimit objektiv.

“Për më tepër, nga dokumentacioni i dorëzuar nga OE i rekomanduar rezulton se i njëjti ka paraqitur listën e kontratave të realizuara për tri vitet e fundit në vlerë totale prej 31,814.00 €.

Kjo tregon qartë se OE i rekomanduar nuk arrin nivelin minimal të kërkuar të të hyrave vjetore prej 40,000.00 € për periudhën e kërkuar.

Madje, duhet theksuar se vlera e kontratave të realizuara zakonisht paraqitet me TVSH, ndërsa të hyrat e deklaruara për qëllime tatimore evidentohen pa TVSH, çka nënkupton se të hyrat reale të OE-së mund të jenë edhe më të ulëta se vlera prej 31,814.00 €.

Pikërisht për këtë arsye, deklaratat e ATK-së dhe pasqyrat financiare paraqesin dokumentet më relevante dhe më të besueshme për vërtetimin e të hyrave reale të operatorit ekonomik.

Nëse Autoriteti Kontraktues do të kërkonte nga OE i rekomanduar deklaratat tatimore të ATK-së, do të mund të vërtetohej qartë nëse OE i rekomanduar e përmbush apo jo kriterin minimal financiar të përcaktuar në Dosjen e Tenderit.

Mosverifikimi substancial i këtij kriteri nga ana e AK-së ka rezultuar me vlerësim jo të drejtë dhe jo objektiv të ofertave.”

**Kërkojmë nga OSHP që të bëjë verifikim të plotë të përmbushjes së kriterit financiar të OE të rekomanduar, duke u bazuar në dokumentet e kërkuara në Dosjen e Tenderit (deklaratat e ATK-së dhe jo vetëm në qarkullimin bankar).**

Në rast se OE nuk ka dorëzuar dokumentacion të mjaftueshëm për të dëshmuar të hyrat reale vjetore, kërkojmë që të konstatohet mospërmbushja e kriterit dhe të bëhet rivlerësim sipas LPP-së, duke respektuar parimin e trajtimit të barabartë dhe vlerësimit objektiv.

#### **Pretendimi nr.4**

Pretendimi 4.1. OE i rekomanduar për kontratë, në “Listën e Pajisjeve”, tek nr. rendor 7, ka deklaruar pajisjen: “**Pompa spërkatëse ULV Elektrostatike**” – **1 copë**. Si dëshmi për këtë pajisje, OE ka dorëzuar Faturën me nr. **119-210-100-25**, të lëshuar më datë **06.05.2025** nga kompania Agrion SH.P.K, ku në përshkrimin e artikullit figuron “**APARAT PËR DEZINFEKTIM ME RRYMË**”.

Nga kjo rezulton se ekziston mospërputhje ndërmjet pajisjes së deklaruar në Listën e Pajisjeve dhe Pajisjes së evidentuar në Faturën e dorëzuar si dëshmi.

OE në Listën e Pajisjeve ka deklaruar specifikisht një “**Pompa spërkatëse ULV Elektrostatike**”, ndërsa dokumenti mbështetës (fatura) nuk e vërteton këtë pajisje, pasi aty figuron vetëm përshkrimi “**Aparat për dezinfektim me rrymë**”, që nuk dëshmojnë se bëhet fjalë për pajisje ULV elektrostatike.

Për rrjedhojë, konsiderojmë se OE i rekomanduar nuk ka arritur të dëshmojë në mënyrë të qartë dhe bindëse posedimin e pajisjes së kërkuar sipas kërkesave të dosjes së tenderit, duke paraqitur dokumentacion që nuk përputhet me deklarin e bërë në Listën e Pajisjeve.

Prandaj, kemi kërkuar nga AK që të rivlerësojë këtë dëshmi dhe të konstatojë se OE i rekomanduar nuk e ka përmbushur kërkesën lidhur me pajisjen e kërkuar por e njehta na është pergjigjur si ne vijim:

**Përgjigje ndaj pretendimit tuaj nr.4.1-** Lidhur me pajisjen e deklaruar në nr. rendor 7 të Listës së Pajisjeve, OE i rekomanduar ka dorëzuar faturën nr. 119-210-100-25, e cila dëshmon posedimin e pajisjes përkatëse për dezinfektim. Komisioni vlerëson se përshkrimi “Aparat për dezinfektim me rrymë” nuk bie në kundërshtim me deklarin “Pompa spërkatëse ULV Elektrostatike”, pasi përshkrimet në faturat tregtare jo gjithmonë paraqesin emërtimin e plotë komercial apo teknik të pajisjes, por identifikojnë natyrën dhe funksionin e saj bazë.

(bashkangjitur fatura e OE dhe një kërkim i thjeshtë në internet- dhe ne faqer. e shitesit në internet)

#### **Kundërshtim ndaj arsytimit të AK për Pergjigjen ndaj pretendimit nr.4.1**

**Përgjigje ndaj pretendimit tuaj nr.4.1-** Lidhur me pajisjen e deklaruar në nr. rendor 7 të Listës së Pajisjeve, OE i rekomanduar ka dorëzuar faturën nr. 119-210-100-25, e cila dëshmon posedimin e pajisjes përkatëse për dezinfektim. Komisioni vlerëson se përshkrimi "Aparat për dezinfektim me rrymë" nuk bie në kundërshtim me deklarin "Pompa spërkatëse ULV Elektrostatike", pasi përshkrimet në faturat tregtare jo gjithmonë paraqesin emërtimin e plotë komercial apo teknik të pajisjes, por identifikojnë natyrën dhe funksionin e saj bazë. (bashkangjitur fatura e OE dhe një kërkim i thjeshtë në internet- dhe ne faqen e shitesit në internet)

Sa i përket përgjigjes së Autoritetit Kontraktues lidhur me Pretendimin nr. 4.1, konsiderojmë se AK nuk i adreson në mënyrë të drejtë faktet e ngritura nga OE ankues.

AK ka arsyetuar se OE i rekomanduar për kontratë ka dëshmuar posedimin e pajisjeve duke u ofruar faturen e blerjes se pajisjes.(fatura nr,119-210-100-25) , në të cilën është shënuar përshkrimi: "Aparat për dezinfektim me rryme".

Ne si OE ankues duke parë dëshmitë e ofruara nga AK(faturën e bashkangjitur nga OE i rekomanduar dhe kërkim në faqen e shitësit në internet)—

 **Agrion**  
AGRION SH.P.K  
Obiliq, Mitrovicë, 10 000, Rr. Llapit Nr. 10, Kosovë

Numri unik identifikues: 810836075  
Numri fiskal: 601071731  
Numri i biznesit: 71029646  
Numri i TVSH: 330221739

Fatura Nr: Best D.O.D. SH.P.K.  
Nr. unik/fiskal: 81247339 /  
Nr. biznes/bdri: /  
Kontakt: +38349851805  
Adresë: Vllazënt Gorvalle, en  
, PERIZAJ - KS

Fatura  
119-210-100-25  
Vlera e mbetur: 165.00  
Njëqind e gjashtëdhjetë e pesë

Njësia Org.	Data e faturës	Afati për pagesë	Referenca	Referenti i juaj	Kushtet					
Dyqani	06.05.2025	16.05.2025			NET 10					
Nr	Shifra	Përshkrimi	Sasia	Njësia	Çmimi pa Tresh	Rabati (%)	Tresh %	Çmimi me rabat	Çmimi shites	Vlera shites
1	100	Aparat për dezinfektim me rryme	1.00	CP	139.831	0.00	10.00	139.831	165.000	165.00
Pas kalimit të afatit të pagesës llogaritet kamata 8% vjetore sipas nenit 382 të LMD-së. Në rast të mos pagesës në afat, procedohet tek instit. i "Përmbarsësit Privat", sipas ligj. të Rep. të Kosovës.										
Vlera pa rabat: 139.83 EUR										
Rabati: 0.00% 0.00 EUR										
Rabati shites: 0.00% 0.00 EUR										
Vlera pa tresh: 139.83 EUR										
Tresh: 10.00% 25.17 EUR										
Vlera për pagesë: 165.00 EUR										


  
Pranoi: \_\_\_\_\_

 Rr. Lidhja e Prizrenit, nr. 248, Prishtinë  
10 000 Prishtinë, Kosovë  
Tel: +383 (0) 44 599 886  
Faks: 038 245 - 887  
Email: agrion.ba@gmail.com

MIR: 810836075  
Nr. Fik: 601071731  
Nr. Biz: 71029646  
TVSH: 330221739  
www.agriononline.com

MLB: 1701001812420050  
IBAN: XK0517010010124000009  
Swift: BKUP10019  
TEB: 2011000248616041

© Copyright ALBTID: 2007 - 2025  
Page 1/1



Tek fatura e ofruar nga OE i rekomanduar, nuk ceket askund që pajisja është ULV ELEKTROSTATIKE, por siq shihet “Aparat për deizenfektim me rrymë” – e hijezuar me ngjyrë të verdhë. Sipas autoritetit, jo cdo gjë ceket në faturat tregtare dhe rrjedhimisht kjo pajisje e ofruar nga OE i rekomanduar i përmbush kriteret e kërkuara ne DT. Por edhe nëse në fatura tregtare nuk ceket se a është, apo nuk është ULV ELEKTROSTATIKE, në vetë dëshminë e ofruar nga AK shohim qartë se pajisja nuk është ULV ELEKTROSTATIKE, në përshkrimin e saj në facebook nga shitësi “Agrion ” shihet shumë mirë pajijsja me emërtim - ”Spërkatëse elektrike për dezinfektim 5L” – e hijezuar me ngjyrë të verdhë.

Jo vetem në faqen e shitësit “Agrion” në rrjetin social facebook, por nga kërkimi në internet shohim pajisjen e njejtë të ofruar nga OE i rekomanduar në Listen e Pajisjeve edhe në dëshminë nga AK, ku vërejmë që kjo pajisje nuk është ULV ELEKTROSTATIKE, por vetëm ULV ELEKTRIKE.

Lista e Pajisjeve e ofruar nga OE i rekomanduar:


Lista e Paisjeve - Best D.D.D. SH.P.K.

Nr.	Prodhuesi dhe Modeli	Ndertimi	Pershkrimi	Sasia
1	Ford Ranger	Xhip Transportues me 4 dyer	Automjete per transportin e personelit dhe materialit	1
2	Opel Combo-C-Van	Pikap me 3 dyer	Automjete per transportin e personelit dhe materialit	1
3	White Fog, Tip: ULV1200	Spërkatëse e jashtme bujqesore (COLD FOGGER MIST BLOWER AND POWER SPRAYER)	Spërkatëse ULV Generator	1
4	Villager	Spërkatëse Motorike VS-30	Spërkatëse Motorike	1
5	Villager	Spërkatëse Motorike DM-14PE	Spërkatëse Motorike	2
6	Villager	Spërkatëse me bateri AGM 16 MBS-2ne1	Spërkatëse me bateri	2
7	WOFden	Pompa spërkatëse ULV Elektrostatike	Spërkatëse ULV elektrike dhe elektrostatike	1
8	Ejoyous	Pompa spërkatëse ULV Elektrostatike	Spërkatëse ULV elektrostatike per dezinfektim	2

Nenshkrimi dhe Vula  
  
 Filiprian Sylja  


05.05.2026

Pajisja nga kërkimi në internet:



The screenshot shows a product listing for a "5L (1.3 Gallon) Electric ULV Fogger Sprayer Machine". The product is blue and white, with a tank and a nozzle. The price is listed as €113. The page includes a 4.3 star rating, a "Write a review" link, and an "Availability: in stock" status. There are also icons for "Fast Shipping", "Free Return", "Secure Packaging", and "100% Original Products". The page also features a "BUY NOW" button and a "ADD TO CART" button.

Dhe ne tabelën e përshkrimit të produktit shohim se:

Brand Name	WOEden
Recommended Uses For Product	Pest Control, Sanitizing, Garden sprayer, Fertilizer sprayer
Included Components	ULV Fogger Sprayer
Model Number	SF20251007B0FK3G7BZH_B0FK3G7BZH_1_tTy2m7
UPC	762849350714
Manufacturer Part Number	WED-ULV
Manufacturer	WOEDEN
Unit Count	1.0 Count
Tank Volume	5 Liters
Color	Blue
Style Name	Gun
Power Source	Corded Electric
Material Type	Plastic
Brand	WOEden
Material	Plastic
Item Weight	5 lbs (2.27 kg)
Date First Available	2025-09-01 05:48:49

Provë:

[https://www.kosovo.ubuy.com/en/product/QR6T41UYG-electric-ulv-fogger-sprayer-machine-with-3-nozzles-portable-cold-fogger-machine-spraying-adjustable-flow-rate-distance-30ft-for-home-hotel-church?srsIid=AfmBOorkyJISRumQGupxsUc10eGj1pbyB0D7JFB4dbon-2Qxcz9\\_3ETB&ref=hm-google-redirect](https://www.kosovo.ubuy.com/en/product/QR6T41UYG-electric-ulv-fogger-sprayer-machine-with-3-nozzles-portable-cold-fogger-machine-spraying-adjustable-flow-rate-distance-30ft-for-home-hotel-church?srsIid=AfmBOorkyJISRumQGupxsUc10eGj1pbyB0D7JFB4dbon-2Qxcz9_3ETB&ref=hm-google-redirect)

<www.facebook.com/photo.php?fbid=580905604224385&set=pb.100069148524756.-2207520000&type=3>

Pra pajisja e paraqitur ne Listen e Pajisjeve me brendin “WOEden” nga OE i rekomanduar – e hijezuar me ngjyrë të verdhë, dhe në dëshmitë e ofruara nga AK në pergjigje ndaj pretendimit 4.1, nuk është pajisje ULV ELEKTROSTATIKE, por vetëm ULV ELEKTRIKE (siq është referuar nga shitësi “Agrion” – Spërkatëse Elektrike për Dezinfektim 5L (në facebook); ose nga faqja në internet “kosovo.ubuy.com” – ULV Fogger Sprayer) gjë që asnjëra nga këto emërtime nuk është ekuivalente me ULV ELEKTROSTATIKE të kërkuara në DT.

Pra bazuar ne hulumtimet e bëra nga ana jonë, dhe në provat e ofruara nga AK pajisja e ofruar nga OE i rekomanduar nuk i plotëson kërkesat e DT-së.

**Pretendimi 4.2.** Gjithashtu OE i rekomanduar për kontratë, në “Listën e Pajisjeve”, tek nr. rendor 8, ka deklaruar pajisjen: “**Ejoyous – Pompa spërkatëse ULV Elektrostatike**” – **2 copë**. Si dëshmi për këto pajisje, OE ka dorëzuar DUD doganor me nr. **R 7066**, të lëshuar

më datë **16.04.2026** nga Eksportuesi: **“Faton Pajaziti, Schlosstrasse 72, 550 Radstadt, AT”**, ku në Paketimi dhe përshkrimi i mallit ka shënuar:

**Pompa elektrostatische dore ULV për dezinfektim**

**ULV SPRAYER**

**Total:2PC**

Gjatë hulumtimit ne kemi konstatuar se modeli i pajisjeve që OE e ka deklaruar në Listën e Pajisjeve – “Ejoyous”, i cili në burimet në internet paraqitet me emërtimin “Ejoyous Electric Atomizer Sprayer”, nga përshkrimet teknike të gjetura në internet rezulton qartë se pajisjet në fjalë nuk klasifikohen si pajisje ULV ELEKTROSTATIKE.

Bazuar në burimet e informacionit të siguruar të cilat janë bashkangjitur më poshtë, evidentohet qartë se këto pajisje jo vetëm që nuk janë ULV ELEKTROSTATIKE, por gjithashtu nuk janë të përshtatshme për kryerjen e dezinfektimit.

amazon Deliver to Kosovo

Search Amazon

EN Hello, sign in Account & Lists Returns & Orders Cart

Shop top categories that ship internationally

Patio, Lawn & Garden • Gardening & Lawn Care • Sprayers & Accessories • Sprayers

Fast atomization  
Large amount of mist  
Ultra fine spray

Ejoyous Electric Atomizer Sprayer, Portable Handheld Nanometer Mist Spray Gun Fogger Machine Cleaning Sprayer for Home Office Car (Black)

Visit the Ejoyous Store  
3.8 ★★★★★ (7)

This item cannot be shipped to your selected delivery location. Please choose a different delivery location.

- **[Fine Spray]** - The electric atomizer sprayer gun is equipped with nanometer nozzles, enabling fast atomization and producing a large amount of mist. The ultra-fine spray provides better coverage and effectiveness in various applications.
- **[Large Capacity]** - The portable handheld mist spray gun comes with a large capacity watering can that can hold 300ml of liquid. With the simple push of a button, the spray gun starts spraying immediately, providing convenience and efficiency for your misting needs.
- **[Material]** - Made of environmentally friendly ABS material, this atomizer fogger ensures a good experience. Its lightweight design makes it easy to carry and use, providing convenience for various applications.
- **[High Performance]** - The principle of constant pressure spray and balanced spray ensures stable pressure and excellent performance. This guarantees a consistent and efficient misting experience. The handheld and cordless design allows for easy portability and use.
- **[Wide Application]** - This atomizer sprayer gun is versatile and suitable for both indoor and outdoor use. It can be used for household cleaning, cars, offices, schools, hotels, hair care, and more. It helps create a healthier environment by effectively distributing a fine mist.

Report an issue with this product or seller

No featured offers available  
Learn more

This item cannot be shipped to your selected delivery location. Please choose a different delivery location.  
Deliver to Kosovo

Add to List

BEBESIRI Nano Sprayer, Recharg...  
3.8 ★★★★★ (2)  
EUR 14.90 vprime  
Sponsored

Nga burimet e tilla nuk mund të konstatohet askund që pajisjet në fjalë janë ULV ELEKTROSTATIKE. Përkundrazi, në foton e paraqitur më poshtë kemi nënvizuar me ngjyrë të kuqe secilin rresht të përshkrimit teknik të kësaj pajisjeje, ku në emërtim paraqiten termet: **“Item Type: Electric Nanometer Automizer, Multifunctional Spray Gun Fogger, Handheld Automizer Sprayer”**. Asnjëri nga termet e lartcekura nuk përfaqëson dhe nuk është ekuivalent me ULV ELEKTROSTATIKE, siq është kërkuar në specifikimet teknike të DT.

#### Features

Using ABS material, lightweight design, easy to carry and use.

nanometer nozzles, fast atomization, large amount of mist, and ultra fine spray.

Principle of constant pressure spray and balanced spray makes the pressure stable and guarantees excellent performance.

Multifunctional Spray Gun Fogger can be used for household cleaning, car, hair care, etc.

HandHeld Atomizer Sprayer suitable for daily use indoors and outdoors, creating a healthier environment.

#### Specification

Item Type: Electric Nanometer Atomizer

Product Capacity: 300ml

Battery: Lithium battery 1500mAh

Purpose: Multifunctional use, can be used for home cleaning, car, hairdressing care, etc.

Shiqo linkun :

<https://www.amazon.com/Ejoyous-Electric-Atomizer-Portable-Nanometer/dp/B0CR9B9PX8>

Gjithashtu, gjatë hulumtimit nga përshkrimi për pajisjen në burimet e tilla ceket se qëllimi i përdorimit të saj është përcaktuar si:

**Purpose: Multifuncional use, can be used for home cleaning, car, hairdressing care, etc.**

(Qëllimi: Përdorim multifunksional, mund të përdoret për pastrimin e shtëpisë, makinës, kujdesin për flokët, etj).

Ky përshkrim dëshmon mjaftueshëm që pajisjet e tilla janë dedikuar për përdorim më të përgjithshëm dhe jo për dezinfektim profesional me teknologjinë ULV Elektrostatike, siq është kërkuar në DT.

Rrjedhimisht, bazuar në hulumtimet e tilla, konsiderojmë që pajisjet e tilla të paraqitura në Listën e Pajisjeve nga OE, nuk i përmbushin kriteret dhe specifikimet teknike të kërkuara në DT. Për këtë arsye, kemi kërkuar nga Autoriteti Kontraktues, respektivisht Komisioni Vlerësues, që për këto dy pajisje të kërkojë nga OE - Faturën , si dhe ndonjë dëshmi nga prodhuesi i pajisjeve, që në mënyrë të qartë konstaton nëse pajisjet e tilla të deklaruara janë pajisje ULV ELEKTROSTATIKE.

Në rast se Autoriteti Kontraktues, respektivisht Komisioni Vlerësues, nuk kryen verifikimet e nevojshme lidhur me pretendimet e ngritura më sipër, ne do ti ndjekim rrugët ligjore, për shkak të dyshimeve për manipulimin e dokumentacionit të paraqitur (DUD-in doganor), si dhe dyshimeve për tentim mashtrimi për pajisjet ULV ELEKTROSTATIKE ndaj AK.

Per kete pretendim AK eshte pergjigjur

**Përgjigje ndaj pretendimit tuaj nr.4.2,** Sa i përket pajisjeve të deklaruara si “Ejoyous – Pompa spërkatëse ULV Elektrostatike”, OE i rekomanduar ka dorëzuar dokumentacion doganor (DUD nr. R 7066), ku qartë evidentohet përshkrimi: “Pompa elektrostatike dore ULV për dezinfektim – ULV SPRAYER (2 copë)”.

hashkangiitur DUD-i doganor dhe një kërkim i thjeshtë në internet- dhe ne faqen e shitesit në internet)

## **Kundërshtim ndaj arsytimit të AK për Pergjigjen ndaj pretendimit nr.4.2**

Sa i përket përgjigjes së Autoritetit Kontraktues lidhur me Pretendimin nr. 4.2, konsiderojmë se e njëjta nuk i adreson në mënyrë të plotë, të argumentuar dhe të drejtë faktet e ngritura nga OE ankues.

AK ka arsyetuar se OE i rekomanduar për kontratë ka dëshmuar posedimin e pajisjeve duke iu referuar DUD-it doganor nr. R7066, në të cilin është shënuar përshkrimi: "Pompa elektrostatische dore ULV për dezinfektim – ULV SPRAYER (2 copë)".

Megjithatë, pretendimi ynë nuk ka qenë nëse në DUD figuron apo jo një përshkrim i tillë, por nëse dokumentacioni i paraqitur vërteton se pajisjet e deklaruara në Listën e Pajisjeve janë realisht pajisje ULV Elektrostatische sipas kërkesave të Dosjes së Tenderit.

OE në Listën e Pajisjeve ka deklaruar pajisjen:

"Ejoyous – Pompa spërkatëse ULV Elektrostatische" – 2 copë.

Ndërsa në DUD nuk evidentohet marka "Ejoyous", modeli i pajisjes, numri serik apo ndonjë karakteristikë teknike që do të mundësonte identifikimin e saktë të produktit të deklaruar.

Rrjedhimisht, ekziston një mospërputhje evidente ndërmjet emërimit specifik të pajisjes së deklaruar në Listën e Pajisjeve dhe përshkrimin në DUD.

Pikërisht për këtë arsye, ne si OE ankues kemi kërkuar që AK të kërkojë dokumentacion shtesë, përkatësisht faturën e blerjes, ose dëshmi nga prodhuesi, për të vërtetuar se pajisja e deklaruar është nga brendi "Ejoyous" dhe se ato pajisje përmbushin kërkesat teknike të kërkuara në DT.

AK nuk ka kërkuar asnjë dokument shtesë për verifikim, por është mjaftuar vetëm me përshkrimin e përgjithshëm të DUD-it.

Gjithashtu, AK në arsyetimin e tij ka deklaruar se është mbështetur edhe në një kërkim në internet në faqen e shitësit, ku mund të shohim gabime apo mungese profesionalizmi nga AK sepse: "faqja e shitësit" - ku AK është mbështetur është "amazon.eg", ndërsa shitësi në DUD-in doganor të ofruar nga OE i rekomanduar, figuron me emrin "Faton Pajaziti". Jo vetëm kaq, në Listën e Pajisjeve OE i rekomanduar ka paraqitur markën "Ejoyous" ndërsa nga mbështetja e AK në faqen e "amazon.eg" ka paraqitur një pajisje të markës "Keenso". Pra qartë shihet se pajisjet që OE i rekomanduar ka paraqitur në Listën e Pajisjeve dhe pajisjet që AK është mbështetur janë krejtësisht të ndryshme.

Faqja ku AK është mbështetur – sic është cekur me lartë Brand Name: Keenso (e hijezuar me ngjyrë të verdhë).



Ndersa shikoni tek Lista e Pajisjeve te deklaruar nga OE i rekomanduar(e) hijezuar me ngjyre te verdhe).

**Lista e Paisjeve - Best D.D.D. SH.P.K.**

Nr.	Prodhuesi dhe Modeli	Ndertimi	Pershkrimi	Sasia
1	Ford Ranger	Xhip Transportues me 4 dyer	Automjete per transportin e personelit dhe materialit	1
2	Opel Combo-C-Van	Pikap me 3 dyer	Automjete per transportin e personelit dhe materialit	1
3	White Fog, Tip: ULV1200	Sperkatëse e jashtme bujqesore (COLD FOGGER MIST BLOWER AND POWER SPRAYER)	Sperkatëse ULV Generator	1
4	Villager	Spërkatëse Motorike VS-30	Spërkatëse Motorike	1
5	Villager	Spërkatëse Motorike DM-14PE	Spërkatëse Motorike	2
6	Villager	Spërkatëse me bateri AGM 16 MBS-2ne1	Spërkatëse me bateri	2
7	WOEden	Pompa spërkatëse ULV Elektrostatike	Spërkatëse ULV elektrike dhe elektrostatike	1
8	Ejoyous	Pompa spërkatëse ULV Elektrostatike	Spërkatëse ULV elektrostatike per dezinfektim	2

Nenshkrimi dhe Vula  
  
 Florian Syla  


05.05.2026

Pas nje kerkimi te thjeshte te bere nga ana jone, shihet qarte qe pajisjet e deklaruar nga OE i rekomanduar jo vetem qe nuk jane ULV ELEKTROSTATIKE, por edhe nuk jane te prodhuara per perdorim profesional.

Provë:

<https://www.amazon.com/Ejoyous-Electric-Atomizer-Portable-Nanometer/dp/B0CR9B9PX8>

amazon Deliver to Kosovo Search Amazon EN Hello, sign in Account & Lists Returns & Orders Cart

All Today's Deals Gift Cards Sell Registry Prime Video Customer Service

Shop top categories that ship internationally

Patio, Lawn & Garden Gardening & Lawn Care Sprayers & Accessories Sprayers

Fast atomization  
Large amount of mist  
Ultra fine spray

Ejoyous Electric Atomizer Sprayer, Portable Handheld Nanometer Mist Spray Gun Fogger Machine Cleaning Sprayer for Home Office Car (Black)

Visit the Ejoyous Store  
3.8 (7)

This item cannot be shipped to your selected delivery location. Please choose a different delivery location.

- [Fine Spray] - The electric atomizer sprayer gun is equipped with nanometer nozzles, enabling fast atomization and producing a large amount of mist. The ultra-fine spray provides better coverage and effectiveness in various applications
- [Large Capacity] - The portable handheld mist spray gun comes with a large capacity watering can that can hold 300ml of liquid. With the simple push of a button, the spray gun starts spraying immediately, providing convenience and efficiency for your misting needs
- [Material] - Made of environmentally friendly ABS material, this atomizer fogger ensures a and experience. Its lightweight design makes it easy to carry and use, providing convenience for various applications
- [High Performance] - The principle of constant pressure spray and balanced spray ensures stable pressure and excellent performance. This guarantees a consistent and efficient misting experience. The handheld and cordless design allows for easy portability and use.
- [Wide Application] - This atomizer sprayer gun is versatile and suitable for both indoor and outdoor use. It can be used for household cleaning, cars, offices, schools, hotels, hair care, and more. It helps create a healthier environment by effectively distributing a fine mist

Report an issue with this product or seller

No featured offers available  
Learn more

This item cannot be shipped to your selected delivery location. Please choose a different delivery location.  
Deliver to Kosovo

Add to List

BEDESRI Nano Sprayer, Recharg...  
3.8 (8)  
EUR 14.90

↑ Top About this item Similar From the Brand Product information Reviews

Ejoyous Electric Atomizer Sprayer, Portable Handheld...

Features

Using ABS material, lightweight design, easy to carry and use.

nanometer nozzles, fast atomization, large amount of mist, and ultra fine spray.

Principle of constant pressure spray and balanced spray makes the pressure stable and guarantees excellent performance.

Multifunctional Spray Gun Fogger can be used for household cleaning, car, hair care, etc.

HandHeld Atomizer Sprayer suitable for daily use indoors and outdoors, creating a healthier environment.

Specification

Item Type: Electric Nanometer Atomizer

Product Capacity: 300ml

Battery: Lithium battery 1500mAh

Purpose: Multifunctional use, can be used for home cleaning, car, hairdressing care, etc.

Ne si OE ankues kemi paraqitur prova nga burime publike ne internet për modelin "Ejoyous Electric Atomizer Sprayer", te paraqitur ne Listen e Pajisjeve nga OE i rekomanduar ku pajisja përshkruhet si:

- Electric Nanometer Atomizer;
- Multifunctional Spray Gun Fogger;
- Handheld Atomizer Sprayer;

si dhe me qëllim përdorimi:

"Multifunctional use, can be used for home cleaning, car, hairdressing care, etc."

Në asnjë pjesë të përshkrimeve teknike të modelit "Ejoyous" nuk evidentohet se pajisja është ULV Elektrostatike apo se është pajisje profesionale për dezinfektim sipas kërkesave të DT.

Pra, shihet qartë që OE i rekomanduar nuk posedon dy pajisjet ULV ELEKTROSTATIKE , gjegjesisht nuk përmbush kërkesat teknike të DT-së.

Kërkojmë nga Eksperti Shqyrtues dhe Paneli i OSHP-së që të obligojë AK-në dhe OE-në e rekomanduar për kontratë të paraqesin:

1. Faturën e blerjes për dy pajisjet e deklaruara;
2. Dokumentacion që identifikon qartë se pajisjet e paraqitura ne Listen e Pajisjeve dhe ne DUD-in doganor jane pajisje ULV Elektrostatike siq jane kerkuar ne DT.

Vetëm pas ofrimit të këtyre deshmive mund të vërtetohet nëse pajisjet e deklaruara janë realisht pajisje ULV Elektrostatike dhe nëse OE i rekomanduar për kontratë i plotëson kërkesat e DT-së.

**Pra, për të gjitha shkeljet e bëra nga AK në drejtimin tonë, ne si OE ankues shpresojmë që do të ketë drejtësi nga ju si OSHP dhe të shqyrtoni ankesën konform provave dhe argumenteve.**

Nga të cekurat më lartë të cilat janë evidente, të prekshme kërkojmë nga OSHP të merr :

### **V E N D I M**

**1.APROVOHET SI E BAZUAR ankesa jone OE.“Besim A.Zejnullahu B.I ”** lidhur me tenderin “Shërbimet e Dezinfektimit, Dezinsektimit dhe Deratizimit për nevojat e KRM Pastërtia SH.A. për objektet administrative dhe operative të saj në të gjitha Njësitë e saj” me nr.të prokurimit KRMe-26-1048-2-2-1

**2. ANULOHET njoftimi për dhënie të kontratës dhe lënda të kthehet në rivlersim.**

**3. SHPËRBLEHEMI me kontratë ne si OE i përgjegjshëm pasi që ne i plotësojmë kriteret e kërkuara te DT-së dhe të shpërblehemi me kontratë.**

4. Gjithashtu, kërkojmë që OE i shpërblyer paraprakisht të eliminohet nga procedura e mëtejshme, pasi i njëjti nuk i plotëson kriteret e përcaktuara në Dosjen e Tenderit, në veçanti kriterin financiar dhe kërkesat tjera të DT të elaboruara në pretendimet e mësipërme. Për rrjedhojë, vlerësimi i tij është bërë në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik.

## **9. Dëmet materiale**

*Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.*

**Demet e konstatuara deri me tani kapin shume rreth 500 €**

## **10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura**

*Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:*

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.

- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

*\*\*\*Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*